

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODMOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b>
---	--	---

13 shtator 2010

SCEL – 09-0005

*Ankuesit*

1. [REDACTED], fshati Rimanishtë, Prishtinë
2. [REDACTED], fshati Abri e Epërme, Drenas
3. [REDACTED], fshati Rimanishtë, Prishtinë
4. [REDACTED], fshati Majanc, Podujevë
5. [REDACTED], Prishtinë
6. [REDACTED], fshati Cerovik, Klinë
7. [REDACTED], rruga Agim Qela; Prishtinë
8. [REDACTED], Fushë Kosovë
9. [REDACTED], fshati Torinë; Lipjan
10. [REDACTED], Prishtinë
11. [REDACTED], Prishtinë
12. [REDACTED], Gadime e Epërme, Lipjan
13. [REDACTED], fshati Gllarevë, Klinë
14. [REDACTED], Prishtinë
15. [REDACTED], fshati Banullë, Lipjan
16. [REDACTED], fshati Peran, Podujevë
17. [REDACTED], fshati Barilevë, Prishtinë
18. [REDACTED], fshati Metehi, Podujevë
19. [REDACTED], fshati Gllamnik, Podujevë
20. [REDACTED], fshati Mazgit, Obiliq
21. [REDACTED], fshati Dumnice, Vushtri
22. [REDACTED], Prishtinë
23. [REDACTED], Prishtinë
24. [REDACTED], Prishtinë
25. [REDACTED], Posta e fundit, Banja e Pejes, Pejë
26. [REDACTED], Lipjan
27. [REDACTED], Skenderaj
28. [REDACTED], fshati Siqevë, Prishtinë
29. [REDACTED], fshati Bains, Drenas
30. [REDACTED], Prishtinë

*Kundër*

*I Padituri*

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit**  
Rr. "Ilir Konushevc, nr. 8, Prishtinë

**Për: Ankuesit dhe të Paditurin**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Dhoma e Posaçme), Trupi Gjykues i përbërë nga Piero Leanza,

Gjyqtar Kryesues, Laura Plesa dhe Ilmi Bajrami, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 13 shtator 2010, lëshon këtë:

## A K T G J Y K I M

1. Ankesat e [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] aprovohen si të bazuara. I Padituri urdhërohet t'i përfshijë ata në listën finale të punëtorëve me të drejta legjitime për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së Trasing. Ankuesit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], pasi që janë pranuar nga i Padituri, duhet të përfshihen në listën finale.
2. Ankesat e parashtruara nga [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] (për të ndjerin [REDAKTUAR]) [REDAKTUAR] refuzohen si të pabazuara.
3. Ankesa e [REDAKTUAR] refuzohet si e papranueshme.

### Rrethanat procedurale:

Më 21 maj 2009, [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr.1) ka parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (tash e tutje "AKP"), përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listë pasi që ka qenë i punësuar në NSH "Trasing" (tash e tutje "NSH") për më shumë se 7 vite që nga 3 gusht 1976 deri 28 mars 1983. Ankuesi ka pohuar se gjatë masave të përkohshme të vendosura nga regjimi serb, të drejtat e tij për pension janë ndaluar. Pas vitit 1999, ai është lajmëruar çdo ditë në NSH duke kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 27 maj 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së dhe nuk ka dëshmi se ai ka punuar në NSH pas vitit 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 2 korrik 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 13 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 25 maj 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 2) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës pohon se i ka plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe ka kërkuar të përfshihet në listë. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në ndërmarrje prej vitit 1974 deri sa janë vendosur masat e dhunshme në vitin 1990 dhe gjithashtu prej vitit 2000 deri në privatizimin e ndërmarrjes. Ankuesi ka bashkangjitur një kopje të vërtetua të librezës së punës dhe një vendim mbi pushimin vjetor.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 29 maj 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë pasi që Ankuesi ka arritur moshën për pension para datës së privatizimit

më 11 prill 2006, dhe prandaj nuk i plotëson kushtet sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Më 24 qershor 2009, Ankuesit i janë dërguar vërejtjet me shkrim për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Sidoqoftë, nuk ka ndonjë shënim të datës së pranimit. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 26 maj 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 3) ka parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në ndërmarrje që nga 10 prill 1974 deri 21 tetor 1993, kur ai është larguar me dhunë nga puna për shkak të masave të përkohshme që janë vendosur në NSH. Ai është lajmëruar rregullisht në punë pas vitit 1999 por nuk i është ofruar ndonjë punë pasi që ndërmarrja nuk ka funksionuar plotësisht. Ankuesi ka bashkangjitur një kopje të vërtetuar të librezës së punës dhe një deklaratë me shkrim mbi marrëdhënien e punës me NSH, të nënshkruar nga dy dëshmitarë.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 2 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së. Sipas librezës së punës të prezantuar nga Ankuesi, marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë më 21 tetor 1993.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 2 korrik 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Në përgjigjen e 3 korrikut 2009, Ankuesi ka pohuar se vërejtjet me shkrim janë të pabazuara dhe nuk duhet të aprovohen pasi që ai është lajmëruar në punë për çdo muaj pas vitit 1999 por nuk i kanë ofruar punën e tij si vozitës.

Më 26 maj 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 4) ka ushtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në këtë ndërmarrje që nga 15 prilli 1978 deri 19 tetor 1993, kur ai është larguar me dhunë nga puna nga masat e dhunshme që ishin vendosur në NSH. Ankuesi ka filluar të punojë përsëri në vitin 2000 deri në datën e privatizimit kur edhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Ankuesi ka bashkangjitur vërtetimin mbi marrëdhënien e punës dhe njoftimin nga AKM.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 2 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listën finale.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 3 korrik 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 14 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 28 maj 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 5) ka ushtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP, në të cilën ka pohuar se i ka plotësuar kushtet ligjore dhe ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në këtë ndërmarrje që nga viti 1974 deri në vitin 1990 kur ai është larguar me dhunë nga puna nga masat e dhunshme që ishin vendosur në NSH. Pas vitit 1999, ai është lajmëruar në punë por nuk i kanë ofruar punë pasi që ndërmarrja nuk funksiononte plotësisht. Ankuesi ka bashkangjitur vërtetimin e punës, një deklaratë nga ish

drejtori i NSH-së se ai është lajmëruar pas vitit 1999 dhe një deklaratë nga një ish punëtor i AKM-së se Ankuesi ka kërkuar punë por është dërguar në pushim pa pagesë.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 9 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Ankuesi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listën finale.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 29 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Në përgjigjen e datës 6 korrik 2009, Ankuesi ka pohuar se ai është lajmëruar rregullisht në punë pas vitit 1999 por edhe pse e kanë përfshirë në listën e pritjes, atij nuk i është ofruar ndonjë punë. Prandaj, ai kërkon të përfshihet në listë sikurse ish punëtorët tjerë.

Më 2 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 6) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në këtë ndërmarrje për 3 vite që nga 1 janari 2000 deri më 23 mars 2004. Ai gjithashtu ka cekur se pas vitit 1999, ai është lajmëruar çdo ditë në punë duke kërkuar të drejtën për 20%. Ankuesi ka bashkangjitur vendimin mbi mbështetjen financiare.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 9 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar deklaratat e tij se i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listën finale. Për më tepër, Ankuesi ka mbërritur moshën për pension para datës së privatizimit, 11 prill 2006.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 1 korrik 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 13 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 3 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 7) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në NSH për 11 vite deri në vitin 1991 kur është larguar me dhunë gjatë masave të përkohshme serbe. Ankuesi është lajmëruar në punë pas vitit 1999 por nuk ka pasur punë për të. Ankuesi ka theksuar se ai është diskriminuar së pari kur është larguar nga puna nga masat e dhunshme serbe e pastaj nga menaxhmenti i NSH-së që nuk ka krijuar kushte për tu kthyer në punë. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës dhe njoftimin nga AKM-ja.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 9 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar deklaratat e tij se është diskriminuar dhe se është kthyer në punë pas vitit 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 29 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 9 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 3 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 8) ka ushtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP, përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se i ka plotësuar kushtet ligjore që të përfshihet në listë pasi që ai ka punuar në NSH për 11 vite prej 4 gusht

1986 deri më 11 korrik 1998. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës dhe dy vendime mbi pranimin në punë.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 9 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së. Sipas librezës së punës të prezantuar nga Ankuesi, marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë më 11 korrik 1998.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 24 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Sidoqoftë, nuk ka shënim të ndonjë date të pranimit të tij. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 3 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 9) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në NSH për afër 17 vite nga 13 korriku 1982 deri më 5 shkurt 1985 dhe nga 10 shkurti 1986 deri më 15 tetor 1993 kur është larguar së bashku me shumë punëtorë tjerë shqiptarë. Ankuesi ka theksuar se ai është lajmëruar në punë më 1 korrik 1999 dhe ka qenë në listën e punëtorëve deri më 11 prill 2006. Ankuesi ka cekur se deri në datën e privatizimit ai ka qenë punëtor duke pritur të kthehet në vendin e tij të punës sipas Ligjit të Punës. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 9 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Kjo ankesë i është parashtruar drejtpërdrejtë Dhomës së Posaçme dhe në bazë të fakteve të prezantuara del se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 30 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 10 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 5 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 10) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP-së në të cilën ka cekur se është diskriminuar dhe ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në NSH për 12 vite, 7 muaj dhe 16 ditë. Në vitin 1992 ai është larguar me dhunë nga puna për shkak të masave të perkohshme serbe. Ankuesi është lajmëruar në punë pas vitit 1999 dhe ka punuar pa pagesë, por nuk e kanë përfshi në listën e të ardhurave personale. Ankuesi ka theksuar se ai është diskriminuar së pari kur është larguar nga puna nga masat e dhunshme serbe e pastaj nga menaxhmenti i NSH-së që nuk ka krijuar kushte për tu kthyer në punë. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 9 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar deklaratat e tij se është diskriminuar dhe se është kthyer në punë pas vitit 1992.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 27 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 7 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 5 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 11) ka ushtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP, në të cilën ka theksuar se i ka plotësuar kushtet ligjore që të përfshihet në listë dhe ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar në NSH prej vitit 1970 deri 1990 kur është larguar nga puna nga masat e dhunshme serbe. Ankuesi është lajmëruar në punë pas vitit 1999 dhe ka punuar deri më 11 prill 2006. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 10 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Kjo ankesë i është parashtruar drejtpërdrejtë Dhomës së Posaçme dhe në bazë të fakteve të prezantuara (kopja e vërtetuar e librezës së punës së mbyllur më 11 prill 2006) del se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 27 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 7 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 5 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 12) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP në të cilën ka cekur se është diskriminuar dhe ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka punuar në NSH deri në vitin 1991 kur është larguar me dhunë nga puna për shkak të masave të dhunshme serbe. Ankuesi është lajmëruar në punë çdo ditë pas vitit 1999, por ndërmarrja nuk ka mundur ti ofrojë punë. Ankuesi është dërguar në pushim me pagesë deri sa ai ka mbushur 65 vjet. Prandaj, ai thotë se është diskriminuar edhe pse ka qenë në listën e të ardhurave personale në kohën e privatizimit. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës, vendimin mbi pushimin vjetor.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 10 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se Ankuesi ka arritur moshën për pension para ditës së privatizimit, më 11 prill 2006, dhe prandaj nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Sipas librezës së punës të paraqitur nga Ankuesi, marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë më 21 nëntor 2004.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 26 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 6 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 5 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 13) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP në të cilën ka cekur se është diskriminuar dhe ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka punuar në NSH prej 13 gushtit 1971. Ankuesi ka pohuar se ka punuar në NSH për më shumë se 20 vite nga të cilat 5 vite në periudhën pas vitit 1999, prej 1 korrikut 2000 deri më 11 prill 2006 kur i është ndërprerë marrëdhënia e tij e punës për shkak të privatizimit. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës dhe vërtetimin e punës nga menaxhmenti i NSH-së.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 10 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se Ankuesi ka arritur moshën për pension para ditës së privatizimit, më 11 prill 2006, dhe prandaj nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 26 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Në përgjigjen e tij të datës 8 korrik 2009, Ankuesi ka theksuar se vërejtjet me shkrim janë të pabazuara në tërësi pasi që Rregullorja përkatëse e UNMIK-ut nuk e përcakton se moshë për pension është një pengesë për marrjen e 20%. Paditësi gjithashtu thekson se në publikimin në media nuk është përmendur asgjë për pensionim. Ankuesi ka theksuar se ai ka qenë punëtor i rregullt që nga viti 1971 deri në ditën e privatizimit dhe prandaj ka qenë në listën e të ardhurave personale në atë kohë. Ankuesi ka pohuar se pasi që ia ka qenë punëtor i rregullt në kohën e privatizimit dhe ka më shumë se 3 vite përvojë pune, ai i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listën e punëtorëve.

Më 8 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 14) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka punuar në NSH prej 17 gushtit 1987 deri 31 tetor 1991 kur është larguar nga puna për shkak të masave të dhunshme serbe. Ankuesi është lajmëruar në punë shumë herë pas vitit 1999 dhe është regjistruar nga qeveria e Kosovës, por nuk i kanë ofruar të kthehet në punë. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës dhe vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 16 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se është kthyer në punë pas vitit 1991, respektivisht 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 27 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 7 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 9 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 15) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se i plotëson kushtet sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Ankuesi ka punuar në NSH prej 18 tetorit 1970 deri 25 mars 1999 kur është larguar nga puna për shkak të masave të përkohshme të organeve serbe. Ankuesi është lajmëruar në punë pas vitit 1999 dhe ka kërkuar të kthehet në vendin e tij të punës disa herë por nuk i kanë ofruar punë. Ankuesi ka vërejtur se ndërmarrja ka marrë punëtorë të ri në vend se tu ofrohet punë punëtorëve të mëparshëm. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës dhe njoftimin nga AKM-ja.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 17 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se është kthyer në punë pas vitit 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 27 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 7 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 9 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 16) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se i plotëson kushtet sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Ankuesi ka pohuar se ka punuar në NSH për 15 vite 7 muaj dhe 6 ditë. Sidoqoftë, për shkak të masave të përkohshme të organeve serbe, i është ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 1993. Ai është lajmëruar në punë pas vitit 1999 por nuk i kanë ofruar punë pasi që ndërmarrja nuk ka funksionuar plotësisht. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 17 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes. Sipas librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi, marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë më 22 mars 1993. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se është kthyer në punë pas vitit 1993, respektivisht 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 27 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 7 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 9 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 17) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se i plotëson kushtet ligjore pasi që ka punuar në NSH për më shumë se 20 vite. Ai ka punuar prej vitit 1972 deri 1999 kur është larguar nga puna për shkak të masave të përkohshme që janë vendosur në ndërmarrje. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës.

Ankuesi ka theksuar se lista finale e punëtorëve është përpiluar në baza diskriminuese pasi që përfshin punëtorët me më pak përvojë pune se sa punëtorët që nuk janë përfshirë në listë. Ankuesi ka kërkuar që Dhoma e Posaçme t'i shqyrtojë punëtorët në listë.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 17 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se është diskriminuar në vitin 1999 dhe se është kthyer në punë pas vitit 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 25 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Sidoqoftë, nuk ka shënime për datën e pranimit. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 10 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 18) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka pohuar se i plotëson kushtet sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe se lista është përpiluar në mënyrë diskriminuese. Ankuesi ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të



hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ka punuar në NSH për më shumë se 11 vite. Ai është lajmëruar në punë pas vitit 1999 por është refuzuar sepse nuk ka pasur punë. Ankuesi ka bashkëngjitur vërtetimin e punës nga menaxhmenti i NSH-së.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 18 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar deklaratën e tij mbi diskriminimin dhe se është kthyer në punë pas vitit 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 27 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 7 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 11 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 19) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ai ka punuar si vozitës në NSH prej 21 majit 1979 deri 31 tetor 1991. Pas vitit 1999, ai është lajmëruar në punë dhe i kanë premtuar se do të punësohet përsëri. Ankuesi ka pohuar se pas vitit 1999, ai me punëtorë tjerë kanë punuar në NSH pa pagesë. Ai ka qenë i regjistruar në NSH deri në kohën e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listë prandaj ndjehet i diskriminuar.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 19 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes. Ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në NSH më 31 tetor 1991 dhe më 13 shtator 1994 ka filluar të punojë në një ndërmarrje tjetër.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 3 korrik 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 13 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 11 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 20) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ai ka punuar si vozitës në NSH prej vitit 1980 deri në kohën e privatizimit dhe prandaj i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listë.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 19 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se, në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, ai ka punuar për NSH-në.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 29 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 9 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 11 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesja Nr. 21), bashkëshortja e të ndjerit Bedri Zeqiri, ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar që bashkëshorti i saj i ndjere të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20%

nga të hyrat e privatizimit. Ajo ka pohuar se ai ka punuar në NSH prej 19 marsit 1984 deri 27 tetor 1993. Ankuesja ka bashkangjitur kopjen e librezës amzë të NSH-së.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 19 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se, Bedri Zeqiri, në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes. Ankuesja ka paraqitur kopjen e librit amzë që tregon se Bedri Zeqiri ka punuar në NSH deri më 27 tetor 1993.

Ankueses i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 27 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 7 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 12 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 22) ka ushtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listë pasi që ka punuar në NSH prej vitit 1971 deri 9 prill 1990 kur është transferuar për të punuar me Shoqatën e Ndërtimtarëve të Kosovës. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës dhe vendimin se ai ka dal në pension që nga 1 shtatori 1995.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 19 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes. Sipas librezës së tij të punës dhe vendimin mbi pensionimin të paraqitura nga Ankuesi, marrëdhënia e punës i është ndërprerë më 1 shtator 1995 pasi që ka arritur moshën për pensionim.

Ankueses i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 27 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 7 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 12 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesja Nr. 23) ka parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesja ka pohuar se ajo është diskriminuar pasi që i plotëson kushtet ligjore për të qenë në listë. Ajo ka punuar në NSH që nga 26 prilli 1982 deri më 15 janar 1991, kur ajo është larguar nga puna për shkak të masave të përkohshme serbe që ishin vendosur në ndërmarrje. Ajo është lajmëruar rregullisht në punë pas vitit 1999 por nuk i është ofruar ndonjë punë pasi që ndërmarrja nuk ka funksionuar plotësisht. Ankuesja ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së saj të punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 19 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesja nuk ka qenë e regjistruar si punëtorë e NSH-së. Ankuesja nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e saja. Sipas librezës së punës të paraqitur nga Ankuesja, marrëdhënia e saj e punës është ndërprerë më 15 janar 1991.

Ankueses i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 29 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 9 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 12 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 24) ka parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai i plotëson kushtet ligjore për të qenë në listë pasi që ka punuar në NSH që nga 13 shtatori 1983 deri më 25 mars 1999. Ai është lajmëruar rregullisht në punë pas vitit 1999 por nuk i është ofruar ndonjë punë pasi që ndërmarrja nuk ka funksionuar plotësisht. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 19 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë për shkak se në kohën e privatizimit, më 11 prill 2006, Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Sipas librezës së punës të paraqitur nga Ankuesi, marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë më 25 mars 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 29 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 9 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 12 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 25) ka parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai i plotëson kushtet ligjore për të qenë në listë pasi që ka punuar në NSH që nga viti 1966 deri në ditën e privatizimit. Ai është lajmëruar rregullisht në punë pas vitit 1999 por nuk i është ofruar ndonjë punë pasi që ndërmarrja nuk ka funksionuar plotësisht. Ankuesi ka bashkangjitur vendimin mbi pushimin vjetor dhe vërtetimin e punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 19 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. AKP-ja ka cekur se afati për dorëzimin e ankesës ishte 13 qershori por ankesa është dorëzuar më 15 qershor 2009 dhe prandaj është e paafatshme. Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se është kthyer në punë pas vitit 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 30 qershor 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 10 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 12 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 26) ka parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ai ka punuar si roje në NSH që nga 6 gushti 1996. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 19 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. AKP-ja ka cekur se afati për dorëzimin e ankesës ishte 13 qershori por ankesa është dorëzuar më 15 qershor 2009 dhe prandaj është e paafatshme. Sipas librezës së punës të paraqitur nga Ankuesi, marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë më 25 mars 1999 dhe ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi se është kthyer në punë pas vitit 1999.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 1 korrik 2009 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Afati për parashtrimin e përgjigjes ka skaduar më 13 korrik 2009. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar deri në datën e marrjes së këtij aktvendimi.

Më 22 qershor 2009 ankesa e [REDAKTUAR] është regjistruar pranë Dhomës së Posaçme (Ankuesi Nr. 27). Ankuesi ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Më 17 shtator 2009 ankesa është refuzuar si e papranueshme pasi që është parashtruar pas afatit.

Më 30 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 28) ka parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Më 17 shtator 2009 ankesa është refuzuar si e papranueshme pasi që është parashtruar pas afatit.

Më 29 qershor 2009 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 29) ka parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Më 17 shtator 2009 ankesa është refuzuar si e papranueshme pasi që është parashtruar pas afatit.

Më 24 maj 2010 [REDAKTUAR] (Ankuesi Nr. 30) ka parashtruar një ankesë pranë Dhomës së Posaçme kundër AKP përmes së cilës ka kërkuar të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejtën për 20% nga të hyrat e privatizimit. Ankuesi ka punuar si Shef i Makinave Ndërtimore që nga 11 tetori 1963 deri 2 tetor 1997 kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të masave të përkohshme që janë vendosur në NSH. Ai është lajmëruar rregullisht në punë pas vitit 1999 por nuk i është ofruar ndonjë punë pasi që ndërmarrja nuk ka funksionuar plotësisht. Në vitin 2001, Ankuesi ka filluar një punë tjetër deri sa ka mbërrimoshën për pension. Ankuesi ka bashkangjitur dy vendime lidhur me punësimin e tij dhe ndërprerjen e punës në institucionin parashkollor.

Në vërejtjet e saj me shkrim të dorëzuara më 1 qershor 2009, AKP ka pohuar se ankesa duhet të refuzohet si e pabazë. Afati për dorëzimin e ankesës pranë Dhomës së Posaçme ishte 13 qershori por ankesa është dorëzuar më 24 maj 2010.

Ankuesit i janë dorëzuar vërejtjet me shkrim më 5 korrik 2010 për tu përgjigjur brenda 10 (dhjetë) ditëve. Në përgjigjen e 6 korrikut 2010, Ankuesi ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme ta shqyrtojë lëndën e tij. Ai ka pohuar se nuk e ka parë publikimin në media dhe është informuar se punëtorët që kanë punuar deri në vitin 1998 nuk do të përfshiheshin në listë.

Më 13 korrik 2009, AKP-ja ka dorëzuar pranë Dhomës së Posaçme Kërkesën për Përcaktimin e Statusit për NSH-në, Vërejtjet që datojnë në prill 2009 të përgatitura nga Komisioni për Shqyrtim të AKP-së, kopjet e publikimeve në gazetata në gjuhën serbe: Vjesti të datave 22 dhe 24 maj 2009 dhe Blic të datave 21, 23 dhe 24 maj 2009, kopjet e publikimeve në gazetata në gjuhën shqipe: Kosova Sot të 21, 22 dhe 23 majit 2009 dhe Koha Ditore e 21, 22 dhe 23 majit 2009 dhe kopjen e Librit Amzë të NSH-së.

Më 17 shtator 2009, Dhoma e Posaçme i ka refuzuar ankesat e ushtruara nga Bajram Uka, Musa Berisha, Sali Zariqi si të ushtruara pas afatit.

Për shkak të burimeve të kufizuara për përkthim, Dhoma e Posaçme nuk ka mundur të kryejë përkthimet në gjuhën angleze të të gjitha ankesave, dokumenteve përcjellëse dhe

parashtrësive pasuese të Ankuesve brenda afatit në pajtim me nenin 67.11 të UA të UNMIK-ut 2008/6.

Më 1 korrik 2010, AKP-ja ka pohuar gjithashtu se pas themelimit të Komisionit të Ri për Shqyrtimin e Listës së Punëtorëve, të përberë nga dy anëtarë vendorë dhe një anëtar ndërkombëtar që vepron si kryetar i komisionit, lista e punëtorëve nuk ka pësuar ndonjë ndryshim shtesë. AKP-ja ka bashkangjitur Vërejtjet nga Komisioni për Shqyrtimin e Listës së Punëtorëve të datës 30 qershor 2010.

### **Faktet:**

Më 11 prill 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (KTA) ka privatizuar Ndërmarrjen Shoqërore “Trasing” në Prishtinë (gjithashtu e quajtur NSH “Put”, “Kosmetput” dhe “Kosometput”).

AKP-ja ka publikuar listën e punëtorëve legjitim në gazetën në gjuhën serbe “Vjesti” në datat 22 dhe 24 maj 2009 dhe në gazetën në gjuhën serbe “Blic” në datat 21, 23 dhe 24 maj 2009. AKP-ja ka publikuar listën e punëtorëve legjitim në gazetën në gjuhën shqipe “Kosova Sot” në datat 21, 22 dhe 23 maj 2009 dhe në gazetën në gjuhën shqipe “Koha Ditore” më 21, 22 dhe 23 maj 2009.

Afati për parashtrimin e ankesave pranë Dhomës së Posaçme, në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, ka skaduar më 13 qershor 2009. Dhoma e Posaçme i ka regjistruar 30 ankesa që kërkojnë përfshirjen në listën finale të punëtorëve legjitim të përpiluar nga AKP-ja.

Ankuesi Nr. 1 [REDAKTUAR], data e lindjes 7 gusht 1942, ka punuar në NSH prej 3 gushtit 1976 dhe marrëdhënia e tij e punës nuk është ndërprerë, sipas kopjes së vërtetuar të librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 2 [REDAKTUAR], data e lindjes 29 mars 1939, ka punuar në NSH prej 26 prillit 1974 deri 4 nëntor 1991, 23 shtator 1994 deri 1 tetor 1998 dhe nga 10 prilli 2000 deri më 1 korrik 2005 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës dhe vendimit mbi pushimin vjetor të dorëzuar nga Ankuesi. Ankuesi ka hyrë në moshën për pensionim para datës së privatizimit, 11 prill 2006.

Ankuesi Nr. 3 [REDAKTUAR], data e lindjes 10 korrik 1946, ka punuar në NSH prej 10 prillit 1974 deri 21 tetor 1993 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 4 [REDAKTUAR], data e lindjes 27 gusht 1958, ka punuar në NSH prej 15 prillit 1978 deri 19 tetor 1993 dhe nga 15 marsi 2000 deri 11 prill 2006 siç dëshmohet nga vërtetimi i punës i dorëzuar nga Ankuesi dhe libri amzë, numër 63, të dorëzuar nga e paditura.

Ankuesi Nr. 5 [REDAKTUAR], data e lindjes 10 nëntor 1953, ka punuar në NSH prej 8 prillit 1974 deri 14 tetor 1993 siç dëshmohet nga vërtetimi i punës i dorëzuar nga Ankuesi. Ai është lajmëruar në punë pas vitit 1999 siç dëshmohet nga deklarata e ish drejtorit të NSH-së e datës 28 maj 2009 dhe deklarata e ish punëtorit të AKM-së e datës 2010.

Ankuesi Nr. 6 [REDACTED], data e lindjes 5 maj 1939, ka punuar në NSH prej 1971 siç dëshmohet nga vendimi mbi mbështetjen financiare të datës 29 janar 2003. Ankuesi ka mbërri moshën për pension para datës së privatizimit, 11 prill 2006.

Ankuesi Nr. 7 [REDACTED], data e lindjes 1 mars 1948, ka punuar në NSH prej 1 shtator 1980 deri 31 tetor 1991 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 8 [REDACTED], data e lindjes 9 gusht 1965, ka punuar në NSH prej 4 gusht 1986 deri më 11 korrik 1998 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 9 [REDACTED], data e lindjes 30 mars 1959, ka punuar në NSH prej 13 korrik 1982 deri me 5 shkurt 1985, nga 10 shkurt 1986 deri 15 tetor 1993 dhe nga 1 korrik 1999 deri në datën e privatizimit, 11 prill 2006, siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 10 [REDACTED], data e lindjes 6 prill 1959, ka punuar në NSH prej 22 nëntor 1978 deri 11 shtator 1979 dhe nga 1 janari 1981 deri 28 tetor 1992 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 11 [REDACTED], data e lindjes 19 gusht 1944, ka punuar në NSH prej 2 qershor 1970 deri 31 gusht 1993 dhe nga 1 korrik 1999 deri në datën e privatizimit, 11 prill 2006, siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 12 [REDACTED], data e lindjes 20 nëntor 1939, ka punuar në NSH prej 9 maj 1977 deri 28 dhjetor 1977, 5 qershor 1978 deri 5 dhjetor 1978, 19 mars 1979 deri 19 dhjetor 1979, 26 nëntor 1980 deri 31 mars 1998 dhe nga 1 korrik 1999 deri 21 nëntor 2004 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi. Ankuesi ka mbërri moshën për pension para datës së privatizimit, 11 prill 2006.

Ankuesi Nr. 13 [REDACTED], data e lindjes 27 dhjetor 1940, ka punuar në NSH prej 13 gusht 1971 dhe marrëdhënia e tij e punës nuk është ndërprerë siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi. Ankuesi ka mbërri moshën për pension para datës së privatizimit, 11 prill 2006.

Ankuesi Nr. 14 [REDACTED], data e lindjes 25 korrik 1961, ka punuar në NSH prej 17 gusht 1987 deri 31 tetor 1991 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 15 [REDACTED], data e lindjes 13 mars 1943, ka punuar në NSH prej 18 tetor 1970 deri 25 mars 1999 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 16 [REDACTED], data e lindjes 16 mars 1950, ka punuar në NSH prej 16 gusht 1977 deri 22 mars 1993 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 17 [REDACTED], data e lindjes 4 dhjetor 1946 ka punuar në NSH prej 9 gusht 1977 deri 25 mars 1999 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 18 [REDACTED], data e lindjes 12 shkurt 1955, ka punuar në NSH prej 8 shtator 1980.

Ankuesi Nr. 19 [REDACTED] ka punuar në NSH prej 21 maj 1979 deri 31 tetor 1991 kur i është ndërprerë marrëdhënia e tij e punës siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga i padituri. Sipas librezës së punës më 13 shtator 1994 Ankuesi ka filluar të punojë në një ndërmarrje tjetër.

Ankuesi Nr. 20 [REDACTED], data e lindjes 14 shkurt 1947, ka punuar në NSH prej 15 gusht 1980 marrëdhënia e tij e punës nuk është ndërprerë sipas kopjes së librezës së punës të dorëzuar nga i padituri.

[REDACTED] bashkëshorti i ndjerë i Ankueses Nr. 21 [REDACTED], ka punuar në NSH prej 19 mars 1984 deri 27 tetor 1993 siç dëshmohet nga një kopje e librit amzë të NSH-së, numër 514, e dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 22 [REDACTED], data e lindjes 4 dhjetor 1934, ka punuar në NSH prej 9 gusht 1971 deri 9 prill 1990 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi. Ankuesi ka qenë i pensionuar prej 1 shtator 1995 siç dëshmohet nga vendimi mbi pensionimin e datës 21 nëntor 1995 e dorëzuar nga Ankuesi. Ankuesi ka mbërrirë moshën për pension para datës së privatizimit, 11 prill 2006.

Ankuesja Nr. 23 [REDACTED], data e lindjes 15 shkurt 1963, ka punuar në NSH prej 26 prill 1982 deri 15 janar 1991 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 24 [REDACTED], data e lindjes 6 shkurt 1963, ka punuar në NSH prej 13 shtator 1983 deri 31 maj 1985, prej 2 qershor 1986 deri 2 gusht 1993 dhe nga 1 gusht 1995 deri 25 mars 1999, siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 25 [REDACTED], data e lindjes 16 maj 1944, ka punuar në NSH prej 4 maj 1973 deri 25 mars 1999 siç dëshmohet nga vërtetimi i punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 26 [REDACTED], data e lindjes 1 nëntor 1956, ka punuar në NSH prej 6 gusht 1996 deri 25 mars 1999 siç dëshmohet nga kopja e vërtetuar e librezës së punës të dorëzuar nga Ankuesi.

Ankuesi Nr. 30 [REDACTED], data e lindjes 15 tetor 1939, ka mbërrirë moshën për pension para datës së privatizimit, 11 prill 2006.

### **Arsyet Ligjore:**

Neni 67.10 i UA të UNMIK-ut 2008/6 thotë: “Seanca gojore mbahet nëse ankuesi ose i padituri kërkon me shkrim që ajo të mbahet. Paneli Gjykses mund të vendosë se a do të mbajë

*seancë gojore. Nëse mbahet seanca gojore, Paneli Gjykses e njofton me shkrim ankuesin dhe Agjencinë për datën e mbajtjes së.”*

Asnjëri nga Ankuesit nuk ka bërë kërkesë për seancë gojore. Prandaj, në pajtim me nenin 67.10 të Ua të UNMIK-ut 2008/6, Dhoma e Posaçme ka vendosur të vazhdojë me aktgjykimin mbi meritat e lëndës, në bazë të dokumentacionit dhe dëshmimeve të dorëzuara.

Ankuesit kanë kërkuar nga Dhoma e Posaçme të përfshihen në listën e punëtorëve legjitim për të marrë 20% nga të ardhurat nga shitja e NSH-së “Trasing” të përpiluar nga APK-ja. Të gjithë Ankuesit kanë pohuar se i plotësojnë kushtet ligjore për tu përfshirë në listë.

Sipas nenit 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore “(...) të punësuarit e Ndërmarrjeve Shoqërore kanë të drejtë parësore të përfitojnë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi. Kjo pjesë do të jetë 20 % e të ardhurave nga shitja e aksioneve të një filiali korporate në varësi të një ndërmarrjeje me pronësi shoqërore, që është privatizuar në përputhje me nenin 8 të Rregullores nr. 2002/12. Shuma ndahet në dobi të të punësuarve me të drejta legjitime në përputhje me këtë nen.”

Në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/3:

“Lista zyrtare e të punësuarve me të drejta legjitime e lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftimin për të drejtën e ankesës, në pajtim me paragrafin 10.6, publikohen në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetatat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetatat kryesore në gjuhën serbe.”

Më 13 qershor 2009, AKP-ja ka publikuar, në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, listën e punëtorëve në gazetatat kryesore në gjuhën serbe, Vjesti dhe Blic, dhe në gazetatat kryesore në gjuhën shqipe, Kosova Sot dhe Koha Ditore së bashku me njoftimin për të drejtën e ankesës pranë Dhomës së Posaçme,

Procedura për parashtrimin e ankesës pranë Dhomës së Posaçme përshkruhet në nenin 10.6(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, e cila thotë: “Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime. Dhoma e Posaçme shqyrton çfarëdo ankese në bazë të përparësisë dhe merr vendim për këto ankese brenda 40 ditëve pas dorëzimit të tyre.”

Ankesa e [REDAKTUAR] (Ankuesi 30) duhet të refuzohet si e papranueshme në pajtim me nenin 28.3 të Urdhërësës Administrative (UA) të UNMIK-ut 2008/6 lidhur me nenin 28.2 (d) dhe 67.1 të UA të UNMIK-ut 2008/6 dhe nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Ankesa është regjistruar në Dhomën e Posaçme më 24 maj 2010, më shumë se 11 muaj pas 13 qershorit 2009, që ishte afati për parashtrimin e ankesave i përcaktuar sipas nenit 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Për më shumë, ai nuk ka cekur arsye se pse ka ushtruar ankesë për më shumë se 11 muaj pas afatit ligjor, dhe as nuk ka kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme sipas 117 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (të publikuar në Gazetën Zyrtare 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596, i cili është ligj aplikativ në Kosovë sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 dhe nenit 70.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6). Për më shumë, neni 118 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore thotë se kërkesa për kthim në gjendjen e mëparshme duhet të dorëzohet në gjykatë pranë së cilës është dashur të kryhej veprimi i emtuar brenda pesëmbëdhjetë ditësh, duke llogaritur që nga dita kur ka pushuar arsyeja që ka shkaktuar



ometimin dhe, sidoqoftë, pas skadimit të afatit kohor prej tre muajsh që nga data e ometimit, kthimi në gjendjen e mëparshme nuk mund të kërkohej më ( shih, si precedentë, në të njëjtën çështje, ASC-09-0045, Aktvendimi i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të datës 9 mars 2010).

Ankesat e Ankuesve 1-26: [REDACTED]

[REDACTED] dhe [REDACTED], janë dorëzuar me kohë.

Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45 parasheh kushtet ligjore për punëtorët legjitim: *“Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6”.*

Ankesa e parashtruar nga [REDACTED] është aprovuar si e bazuar nga AKP-ja në vërejtjet e saj me shkrim ndaj ankesës të dorëzuara më 9 qershor 2009. Ankesa e parashtruar nga Faruk Kastrati është aprovuar si e bazuar nga AKP-ja në vërejtjet e saj me shkrim ndaj ankesës, të dorëzuara më 10 qershor 2009. Prandaj, pasi që ankesat e lartpërmendura janë pranuar nga i Padituri, kërkesat e Ankuesve janë aprovuar nga Gjykata dhe Ankuesit duhet të përfshihen në listë.

Dhoma e Posaçme gjen se Ankuesit [REDACTED] and [REDACTED] i plotësojnë kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar dhe prandaj, ankesat e tyre aprovohen si të bazuara.

Ankuesi Nr. 4 [REDACTED] ka paraqitur kopjen e vërtetimit të punës që tregon se ka punuar në NSH prej datës 15 prill 1978 deri 19 tetor 1993 dhe prej 15 mars 2000 deri 11 prill 2006. Punësimi i detyrë dëshmohej gjithashtu nga libri amzë, numër 63, të dorëzuar nga i padituri. AKP-ja vlerëson se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se Ankuesi i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listë. Dhoma e Posaçme ka konstatuar se Ankuesi ka punuar në NSH prej datës 15 prill 1978 deri 19 tetor 1993 dhe nga 15 marsi 2000 deri 11 prill 2006. Prandaj, Dhoma e Posaçme, konstaton se sipas dëshmive të paraqitura, Ankuesi ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe se ka qenë i regjistruar në NSH deri në ditën e privatizimit, 11 prill 2006. Prandaj, ankesa e [REDACTED] aprovohet si e bazuar.

Ankuesit [REDACTED] dhe [REDACTED] pohuan se ata janë larguar nga puna gjate periudhës 1991-1999 për shkak të kombësisë shqiptare nga Organet Drejtuese të Masave të Përkohshme të vendosur në NSH. Të gjitha ata kanë pohuar se do të kishin plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, të ndryshuar, po të mos ishin nënshtruar diskriminimit. Prandaj, ata kanë parashtruar ankesat e tyre pranë DHPGJS-së në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar.

Lidhur me dëshmitë që kërkohen për të mbështetur deklaratat e tyre mbi diskriminimin, neni 10.6 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 thotë: "Çfarëdo ankese e dorëzuar në Dhomën e Posaçme me bazë diskriminim si shkak për mospërfshirjen në listën e të punësuarve me të drejta legjitime, duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara për diskriminimin e pretenduar."

Sidoqoftë, neni 8.1 i Ligjit kundër Diskriminimit 2004/3 thotë si vijon:

"8.1. Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin faktet para organit administrativ apo Gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, barra e provës bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

8.2. Paragrafi 8.1 nuk ndalon zbatimin e rregullave të dëshmimit të cilat janë të favorshme për palën paditëse. Paditësi mund të mbrojë rastin e tij të diskriminimit edhe me metoda të tjera përfshirë edhe shfrytëzimin e dëshmimeve statistikore."

Neni 11 i të njëjtit ligj thotë:

"11.1 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të zbatohen të gjitha ligjet e mëparshme nga kjo fushë.

11.2. Dispozitat e legjislacionit që do të nxirren dhe dispozitat në fuqi lidhur me mbrojtjen e parimit të trajtimit të barabartë vlejnë dhe duhet të zbatohen edhe më tutje nëse janë më të favorshme se dispozitat e këtij ligji".

Ligji kundër Diskriminimit 2004/3 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 korrik 2004 dhe është shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/32 më 20 gusht 2004. Në pajtim me nenin 13.1, ky ligj hyn në fuqi tridhjetë ditë pas miratimit nga Kuvendi dhe shpalljes nga PSSP-ja.

Si rezultat, neni 8 i Ligjit kundër Diskriminimit pasi që është miratuar është mbizotërues ndaj nenit 10.6 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Në pajtim me nenin 8 të Ligjit kundër Diskriminimit, kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu, i Padituri duhet ta adresojë deklaratën mbi diskriminimin dhe të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë

Ankuesit

[REDACTED] dhe [REDACTED] kanë pohuar se janë diskriminuar për shkak të Masave të Përkohshme serbe të miratuara nga regjimi serb gjatë periudhës 1990-1999. I Padituri ka vlerësuar se ata nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme që do të vërtetonte deklaratat e tyre. Pa marrë parasysh faktin se barra e dëshmimeve (d.m.th. dëshmi për të vërtetuar të kundërtën e deklaruar nga Ankuesit) në këtë çështje - siç është përmendur më lart - i takon të Paditurit, gjendja në Kosovë gjatë viteve 1990-1999 është në fakt njohuri e ditur (*factus notus*).

Sipas nenit 221 paragrafi 4 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (7/77-1478 të ndryshuar), "Nuk duhen provuar faktet e njohura për të gjithë".

Dhoma e Posaçme vëren se sipas raportit mbi Kërkesën për Përcaktim të Statusit të NSH-së "Trasing", të dorëzuar nga i padituri, Ndërmarrja fillimisht është themeluar si Organizatë Punuese gjersa në vitin 1989 është transformuar në Ndërmarrje Shoqërore. Më 28 dhjetor

1990, janë vendosur Masat e Përkohshme në NSH të cilat kanë qar në heqjen e organeve drejtuese shqiptare dhe zëvendësimin e tyre me organe drejtuese serbe si dhe janë larguar punëtorët për shkak të kombësisë shqiptare. Ky transformim është bazuar në Ligjin serb mbi Transformimin 48/91, i cili nuk është ligj aplikativ sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24.

Ankuesi Nr. 3 [REDACTED] ka paraqitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 10 prill 1974 deri 21 tetor 1993. Ankuesi ka thënë se në vitin 1993 ai është larguar me dhunë nga puna për shkak të Masave të Përkohshme serbe që janë vendosur në NSH. I Padituri ka vlerësuar se marrëdhënia e punës së Ankuesit është ndërprerë më 21 tetor 1993, para kohës së privatizimit dhe prandaj duhet të refuzohet si e pabazuar. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesi Nr. 5 [REDACTED] ka paraqitur kopjen e vërtetimit mbi marrëdhënien e punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 8 prill 1974 deri 14 tetor 1993. Ankuesi ka thënë se në vitin 1993 ai është larguar me dhunë nga puna për shkak të Masave të Përkohshme serbe që janë vendosur në NSH. Ankuesi ka paraqitur deklaratën e ish drejtorit të NSH-së që tregon se është paraqitur në punë pas vitit 1999 dhe një deklaratë nga një ish punëtor i AKM-së se ka kërkuar të punojë por është dërguar në pushim pa pagesë. I Padituri ka vlerësuar se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për tu përfshirë në listën finale. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesi Nr. 7 [REDACTED] ka paraqitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 1 shtator 1980 deri 31 tetor 1991. Ankuesi ka thënë se në vitin 1991 ai është larguar me dhunë nga puna për shkak të Masave të Përkohshme serbe që janë vendosur në NSH. I Padituri ka vlerësuar se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për tu përfshirë në listën finale. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesi [REDACTED] i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesi Nr. 10 [REDACTED] ka paraqitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 22 nëntor 1978 deri 11 shtator 1979 dhe prej 1 janar 1981 deri 28 tetor 1992, kur është larguar me dhunë nga puna për shkak të Masave të Përkohshme serbe. I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për ti mbështet deklaratat e tij se ishte diskriminuar dhe se dëshmitë e prezantuara nuk janë të mjaftueshme për tu përfshirë në listën finale. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesi [REDACTED] i plotëson

kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesi Nr. 14 [REDAKTUAR] ka paraqitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 17 gusht 1987 deri 31 tetor 1991. Ankuesi ka thënë se në vitin 1991 ai është larguar me dhunë nga puna për shkak të Masave të Përkohshme serbe që ishin vendosur në NSH. I Padituri ka vlerësuar se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për tu përfshirë në listën finale. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesi [REDAKTUAR] i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesi Nr. 15 [REDAKTUAR] ka paraqitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 18 tetor 1970 deri 25 mars 1999. Ankuesi ka thënë se në vitin 1999 ai është larguar nga puna për shkak të kombësisë si tij shqiptare nga Masat e Përkohshme që ishin vendosur në NSH. I Padituri ka vlerësuar se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për tu përfshirë në listën finale. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesi [REDAKTUAR] i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesi Nr. 16 [REDAKTUAR] ka paraqitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 16 gusht 1977 deri 22 mars 1993. Ankuesi ka thënë se në vitin 1993 ai është larguar nga puna për shkak të Masave të Përkohshme serbe që ishin vendosur në NSH. I Padituri ka vlerësuar se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për tu përfshirë në listën finale. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesi [REDAKTUAR] i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesi Nr. 17 [REDAKTUAR] ka paraqitur kopjen e vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 9 gusht 1977 deri 25 mars 1999. Ankuesi ka thënë se në vitin 1999 ai është larguar nga puna për shkak të Masave të Përkohshme që ishin vendosur në NSH. I Padituri ka vlerësuar se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për tu përfshirë në listën finale. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesi [REDAKTUAR] i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të

ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankuesja Nr. 23 [REDAKTUAR] ka paraqitur kopjen e vërtetuar të librezës së saj të punës që tregon se ajo ka punuar në NSH prej 26 prill 1982 deri 15 janar 1991. Ankuesja ka thënë se në vitin 1991 ajo është larguar nga puna për shkak të Masave të Përkohshme serbe që ishin vendosur në NSH. Ajo ishte lajmëruar rregullisht në punë pas vitit 1999 por nuk i është ofruar punë pasi që ndërmarrja nuk ka funksionuar plotësisht. I Padituri ka vlerësuar se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për tu përfshirë në listën finale. Dhoma e Posaçme konsideron se i Padituri nuk ka siguruar dëshmi për ta hedhur poshtë deklaratën mbi diskriminimin sipas nenit 8.1 të Ligjit Kundër Diskriminimit. Prandaj, Dhoma konkludon se Ankuesja [REDAKTUAR] i plotëson kushtet ligjore të parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ka qenë në listën e të ardhurave personale për më shumë se tri vite dhe do të kishte qenë në listën e të ardhurave personale të Ndërmarrjes në kohën e privatizimit po të mos i ishte nënshtruar diskriminimit.

Ankesat e [REDAKTUAR]

(për të ndjerin [REDAKTUAR])

janë refuzuar si të pabazuara. Ankuesit nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 të ndryshuar, në bazë të arsyeve të dhëna me poshtë.

Siç u tha më lart, sipas nenit 8 të Ligjit kundër Diskriminimit, nga personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, kërkohet të paraqesin faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Prandaj, kur vetëm Ankuesi pretendon diskriminimin, atëherë i takon të Paditurit, i cili e konteston deklaratën e Ankuesit, të vërtetojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Gjykata vëren se, gjersa disa nga Ankuesit (ankesa e të cilëve është aprovuar) kanë thënë se janë larguar nga puna për shkak të Masave të Përkohshme diskriminuese serbe në periudhën prej 1991-1999, Ankuesit tjerë nuk kanë dhënë ndonjë deklaratë se janë larguar nga puna për shkak të diskriminimit. Në këtë rast, Gjykata nuk mund ta zbatojë nenin 8 të Ligjit kundër Diskriminimit dhe nuk mund të supozojë se ata do të kishin qenë ende të punësuar në kohën e privatizimit në NSH nëse nuk do t'i nënshtroheshin diskriminimit. Ankesat e tyre, si rezultat refuzohen si të pabazuara.

Ankesat e tjera, pa marrë parasysh faktin se ata kanë pretenduar apo jo diskriminimin, nuk kanë qenë të punësuar dhe nuk kanë mundur të jenë të punësuar në kohën e privatizimit për shkak se kanë hyrë në moshën për pension (65 vjet) para datës së privatizimit.

Ankuesi Nr. 1 [REDAKTUAR] ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka filluar të punojë në NSH më 3 gusht 1976; librezja e tij e punës duket se është ende e hapur pasi që nuk tregon ndonjë datë të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Sidoqoftë, vetë punëtori ka pranuar se marrëdhënia e tij e punës në NSH është ndërprerë më 28 mars 1983 dhe nuk ka pretenduar se është larguar për arsye të diskriminimit. AKP-ja vlerëson se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, Ankuesi ka qenë i regjistruar si punëtor i NSH-së. Dhoma e Posaçme konkludon se Ankuesi ka punuar me NSH prej 3 gusht 1976 deri 28 mars 1983. Prandaj, ai nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe ankesa e tij refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 2 [REDACTED] ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka lindur më 29 mars 1939 dhe se ka punuar në NSH prej 26 prill 1974 deri 4 nëntor 1991, 23 shtator 1994 deri 1 tetor 1998 dhe nga 10 prill 2000 deri 1 korrik 2005. I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, pasi që ai ka hyrë në moshën për pension para kësaj date. Dhoma e Posaçme e pranon argumentin e të Paditurit sipas së cilës punëtorët që kanë hyrë në moshën për pension para datës së privatizimit nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kështu që, ankesa e [REDACTED] refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 6 [REDACTED] ka paraqitur vendimin mbi mbështetjen financiare të datës 29 janar 2003 që tregon se ai ka lindur më 5 maj 1939 dhe se ka punuar në NSH prej vitit 1971 deri sa është larguar nga puna për shkak të Masave të Përkohshme të vendosura në NSH. I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, pasi që ai ka hyrë në moshën për pension para kësaj date. Dhoma e Posaçme e pranon argumentin e të Paditurit sipas së cilës punëtorët që kanë hyrë në moshën për pension para datës së privatizimit nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kështu që, ankesa e [REDACTED] refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 8 [REDACTED] ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai punuar në NSH prej 4 gusht 1986 deri 11 korrik 1998. . I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, pasi që marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë më 11 korrik 1998. Ankuesi nuk ka pretenduar se marrëdhënia e tij e punës në NSH i është ndërprerë për shkak të diskriminimit. Dhoma e Posaçme konkludon se Ankuesi nuk ka arritur të vërtetojë se i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kështu që ankesa e [REDACTED] refuzohet si e pabazuar

Ankuesi Nr. 12 [REDACTED] ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka lindur më 20 nëntor 1939 dhe se ka punuar në NSH prej 9 maj 1977 deri 28 dhjetor 1977, 5 qershor 1978 deri 5 dhjetor 1978, 19 mars 1979 deri 19 dhjetor 1979, 26 nëntor 1980 deri 31 mars 1998 dhe prej 1 korrik 1999 deri 21 nëntor 2004. I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, pasi që ai ka hyrë në moshën për pension para kësaj date. Dhoma e Posaçme e pranon argumentin e të Paditurit sipas së cilës punëtorët që kanë hyrë në moshën për pension para datës së privatizimit nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kështu që, ankesa e [REDACTED] refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 13 [REDACTED] ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka lindur më 27 dhjetor 1940 (edhe pse, sipas kopjes së LNJ dhe të gjitha vërtetimeve tjera, ai ka lindur më 3 korrik 1940) dhe se ka punuar në NSH prej 13 gusht 1971, dhe nuk tregohet asnjë datë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Ai ka dorëzuar gjithashtu një vërtetim, të datës 27.6.2006, që thotë se ai ka punuar në NSH “për një kohë të pacaktuar duke filluar më 22.5.1979 deri 13.7.1998” dhe se pas luftës ai është lajmëruar në punë prej 1.7.2000 deri 11.4.2006, kur i ka pushuar marrëdhënia e punës për shkak të privatizimit. Sipas vërtetimit të njëjtë, ai ishte regjistruar në librin amzë, pas lufte, në numër 271. Megjithatë, në kopjen e librit amzë të dorëzuar nga AKP-ja, nuk ekziston numri 271. Për më shumë, ai gjithashtu ka dorëzuar Formularin M-2, që tregon se ai ka punuar deri më 13 korrik 1998. Në fund, Ankuesi nuk ka dhënë ndonjë deklaratë se është larguar nga puna në baza diskriminuuese. I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ishte i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, pasi që ka hyrë në moshën për pension para kësaj date. Ankuesi ka

thënë përkundrazi se Rregullorja përkatëse e UNMIK-ut nuk e përcakton moshën për pension si një pengesë për shpërndarjen e 20% dhe as nuk ka pasur ndonjë lajmërim në publikimin e finalistëve në media. Megjithëkëtë, edhe nëse nuk e marrim parasysh se Ankuesi ka hyrë në moshën për pension para privatizimit, duhet të vërehet se ai nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se ka punuar deri 11.4.2006, për shkak të kundërthënies mes dokumentacionit të dorëzuar, ku vetëm vërtetimi i datës 27.6.2006 thotë se ai ka punuar deri në kohën e privatizimit. Duhet të ceket gjithashtu se ky vërtetim nuk mund të konsiderohet si dëshmi e mjaftueshme për kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës pasi që nuk përkon me librin amzë (ku emri i Ankuesit dhe numri i regjistrimit 276 nuk paraqiten fare). Për të gjitha këto arsye, Dhoma e Posaçme e pranon argumentin e të Paditurit sipas së cilit ankuesi nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kështu që, ankesa e [REDAKTUAR] refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 18 [REDAKTUAR] nuk ka dorëzuar kopjen e librezës së tij të punës por ka dorëzuar kopjen (e pavërtetuar) të vërtetimit mbi marrëdhënien e punës të lëshuar nga grupi menaxhues i NSH-së më 23 maj 2006 që tregon se ai ka punuar në NSH prej 8 shtator 1980 deri 11 prill 2006 i regjistruar në librin amzë me numër 285. Megjithëkëtë, ai gjithashtu ka cekur se pas vitit 1999 ai ka provuar të kthehet në punë por nuk ka pasur punë për të. I Padituri ka kundërshtuar duke thënë se nuk ekziston numri i tillë (285) në librin amzë dhe se Ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar deklaratën e tij mbi diskriminimin dhe mbi kthimin e tij në punë pas vitit 1999. Gjykata vëren se nga libri amzë del se numri i fundit është 284 dhe se nuk ka shënim për numrin 285. Gjithashtu, Ankuesi pranon edhe vet se ai ka punuar “11 vite” dhe se pas vitit 1999 nuk ka qenë i punësuar më në NSH. Këto janë fakte të pafavorshme që janë pranuar nga vet Ankuesi dhe prandaj nuk përbejnë provë të vlefshme për rrethanat e cekura më lart (shih nenin 221 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore). Prandaj, dokumenti i dorëzuar nga Ankuesi – që është në kundërthënie me librin amzë dhe me faktet e pranuar nga vet Ankuesi – nuk mund të pranohet si dëshmi se ai ka punuar në NSH deri në kohën e privatizimit (2006). Në të vërtetë, ky dokument është kontestuar në mënyrë ekspresive nga AKP-ja dhe nuk është kopje e vërtetuar e origjinalit, e cila asnjëherë nuk është dorëzuar nga Ankuesi. Për më shumë, Gjykata vëren se Ankuesi nuk ka pretenduar se ai është larguar në periudhën 1991-1999 për shkak të masave të përkohshme diskriminuese serbe. Dhoma e Posaçme gjen se Ankuesi nuk i ka vërtetuar deklaratat e tij dhe si rezultat ankesa e tij refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 19 [REDAKTUAR] ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai punuar në NSH prej 21 maj 1979 deri 31 tetor 1991 dhe prej 13 shtator 1994 ai ka filluar të punojë në një ndërmarrje tjetër. I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, pasi që marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë më 31 tetor 1991. Dhoma e Posaçme konkludon se Ankuesi nuk ka arritur të vërtetojë se i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Në të vërtetë, ai nuk ka pohuar se marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë në vitin 1991 për shkak të masave diskriminuese. Për më shumë, nga librezja e punës del se në vitin 1994 ai ka filluar të punojë në një ndërmarrje tjetër. Kështu që ankesa e [REDAKTUAR] refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 20 [REDAKTUAR], ka cekur se ai ka punuar në NSH prej vitit 1980 deri në privatizimin e ndërmarrjes. Ankuesi nuk ka bashkëngjitur ndonjë dokument që vërteton kohëzgjatjen e marrëdhënies së tij të punës në NSH dhe nuk ka potencuar diskriminimin. Sipas kopjes së librezës së tij të punës – të dorëzuar nga AKP-ja – Ankuesi ka punuar në NSH prej datës 15 gusht 1980 për 11 vite, 3 muaj dhe 3 ditë. Prandaj, edhe pse nuk ka datë të

mbylljes në “katrorin” përkatës të librezës, si përfundim del se marrëdhënia e punës i është ndërprerë më 18 nëntor 1991. AKP-ja vlerëson se dëshmitë e prezantuara nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se Ankuesi i plotëson kushtet ligjore për tu përfshirë në listë. Dhoma e Posaçme vëren se Ankuesi nuk ka pretenduar se marrëdhënia e tij e punës në NSH i është ndërprerë për arsye diskriminuese dhe se sipas dëshmive të paraqitura nuk ka provë se Ankuesi ka punuar në NSH deri në kohën e privatizimit. Kështu që ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ankuesja Nr. 21 [REDAKTUAR] thotë se ajo është bashkëshortja e të ndjerit [REDAKTUAR]. Ankuesi ka paraqitur një kopje të librit amzë të NSH-së, numër 514, që tregon se [REDAKTUAR] ka punuar në NSH prej 19 mars 1984 deri 27 tetor 1993. Ankuesja ka dorëzuar gjithashtu edhe vendimin mbi trashëgiminë 145/2010 nga e cila shihet se ajo është trashëgimtarja ligjore e të ndjerit [REDAKTUAR]. I padituri ka vlerësuar se [REDAKTUAR] në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, nuk ka qenë i regjistruar si punëtor në NSH. Dhoma e Posaçme konstaton se Ankuesja nuk ka mundur të vërtetojë se [REDAKTUAR] i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Ankuesja nuk ka pretenduar ndonjë diskriminim, dhe as nuk i ka precizuar arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në vitin 1993. Për më shumë, nuk është dorëzuar kopja e librezës së punës. Kështu që, ankesa e [REDAKTUAR] refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 22 [REDAKTUAR] ka paraqitur kopjen e librezës së tij të punës që tregon se ai ka lindur më 4 dhjetor 1934 dhe se ka punuar në NSH prej 9 gusht 1971 deri 9 prill 1990. Në pajtim me vendimin mbi pensionimin të datës 21 nëntor 1995 të dorëzuar nga Ankuesi, ai është në pension që nga 1 shtatori 1995. Për më shumë, Ankuesi e pranon edhe vet se ai ka punuar tek i Padituri vetëm deri 9.4.1990 dhe se nga ajo datë deri në vitin 1995 ai ka punuar për një ndërmarrje tjetër (që pasqyrohet edhe në librezën e tij të punës). Ai thotë se punëdhënësi i ri (Shoqata e Ndërtimtarëve të Kosovës) ka përfshirë në vete edhe NSH-në “Put”, por nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi për të vërtetuar këtë çështje. Për çdo rast, librezja e tij e punës vërteton se duke filluar nga 10.7.1991 Ankuesi ka punuar në një NSH tjetër (“Kosing”), e cila duket se nuk ka lidhje me NSH “Put”. I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, 11 prill 2006, pasi që ai ka hyrë në moshën për pension para kësaj date. Në bazë të arsyeve të dhëna më lart, Dhoma e Posaçme e pranon argumentin e të Paditurit sipas së cilës Ankuesi nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kështu që, ankesa e [REDAKTUAR] refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 24 [REDAKTUAR] ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës me datën e lindjes 6 shkurt 1963, që tregon se ai ka punuar në NSH prej 13 shtator 1983 deri 31 maj 1985, prej 2 qershor 1986 deri 2 gusht 1993 dhe prej 1 gusht 1995 deri 25 mars 1999. I Padituri ka vlerësuar se Ankuesi nuk ka qenë i regjistruar në NSH në kohën e privatizimit, 11 prill 2006. Ai nuk ka pretenduar se marrëdhënia e tij e punës në NSH i është ndërprerë më 25 mars 1999 për shkak të diskriminimit. Dhoma e Posaçme konkludon se Ankuesi nuk ka arritur të vërtetojë se i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Kështu që ankesa e [REDAKTUAR] refuzohet si e pabazuar.

Ankuesi Nr. 25 [REDAKTUAR] nuk ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës por ka paraqitur kopjen e vërtetimit mbi marrëdhënien e punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 4 maj 1973 deri 25 mars 1999. I Padituri ka vlerësuar se ankesa është parashtruar pas afatit të datës 13 qershor 2009 dhe se Ankuesi nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se është kthyer në punë pas vitit 1999. Dhoma e Posaçme



konstaton se Ankesa është dorëzuar me kohë (12 qershor 2009, siç është shënuar në Zyrën e Regjistrimit nën “datën e parashtrimit” në faqen e parë të shkresave të lëndës). Megjithatë, Ankuesi nuk ka pretenduar se ai është larguar nga puna më 25 mars 1999 për arsye diskriminuese, por vetëm se nuk ka pasur punë për të në NSH. Për më shumë, ankesa përmban deklaratë kundërthënëse, ku Ankuesi pohon se ai ka punuar në NSH “prej vitit 1966 deri në shitjen/privatizimin”, dhe pastaj ai thotë se pas vitit 1999 ai nuk ka mundur të punojë sepse nuk ka pasur punë të mjaftueshme në NSH. Prandaj, Ankuesi nuk ka arritur të vërtetojë se i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe ankesa e tij refuzohet si e pabazuar

Ankuesi Nr. 26 [REDAKTUAR] ka paraqitur një kopje të vërtetuar të librezës së tij të punës që tregon se ai ka punuar në NSH prej 6 gusht 1996 deri 25 mars 1999. I Padituri ka vlerësuar se ankesa është parashtruar pas afatit të datës 13 qershor 2009 dhe se marrëdhënia e punës së Ankuesit është ndërprerë më 25 mars 1999 dhe se ai nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se ai është kthyer në punë pas vitit 1999. Dhoma e Posaçme konstaton se ankesa është parashtruar me kohë (12 qershor 2009, si më lart). Megjithatë, Ankuesi nuk ka pretenduar se është larguar nga puna në vitin 1999 për shkak të diskriminimit, dhe as nuk thotë në ankesën e tij se kur dhe pse ka pushuar marrëdhënia e tij e punës. Prandaj, Ankuesi nuk ka arritur të vërtetojë se i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe si rezultat ankesa e tij refuzohet si e pabazuar

Prandaj, Dhoma e Posaçme vendos si në dispozitiv.

#### **Këshillë Juridike:**

Në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktvendimi mund t’i ushtrohet me shkrim Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi.

Piero Leanza, Gjyqtar Kryesues,  
EULEX

[nënshkrimi]

Laura Plesa, Gjyqtar,  
EULEX

[nënshkrimi]

Ilmi Bajrami, Gjyqtar

[nënshkrimi]

Tobias Lapke,  
Regjistruer, EULEX

[nënshkrimi]